



BASHKIA
TIRANË
REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DREJTORIA E KONVIKTEVE TË SHKOLLAVE TË MESME

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM
NË MARRËVESHJEN KUADËR**

Për: **Shoqërinë “4 S” sh.p.k**

Adresa: Fier Lushnje Lagjja Xhevdet Nepravishta, Rruga Çajupi, godine nje kateshe, mbrapa shkolles Liri Kazazi nr 199.

* * *

Procedura e prokurimit: “Procedurë e Hapur”/Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik për secilin lot ku te gjitha kushtet jane te përcaktuara, me objekt: **“Blerje artikuj ushqimorë për Konviktet e Shkollave të Mesme për vitin 2020”**, Fondi limit /Vlera e pritshme e kontratës **13.986.704 (trembëdhjetë milion e nëntëqind e tetëdhjete e gjashtë mijë e shtatëqind e katër) lekë pa tvsh- Nr. Ref 44283-11-20-2019**

Numri i referencës së procedurës / **Loti i Parë: “Blerje bukë për Konviktet e Shkollave te Mesme”, Nr. REF-44290-11-20-2019**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj]*

“Blerje bukë për Konviktet e Shkollave te Mesme”, Tirane.

Artikujt dhe sasia e parashikuar:

Nr.	Artikulli	Njësia	Sasia e pritshme
	LOTI I PARE		
1	BUKE	cope	28 000

Kohëzgjatja e kontratës do të jetë 366 (treqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) ditë nga data e nenshkrimit e marrëveshjes kuadër.

Fondi limit për lotin e tretë : **“Blerje bukë për Konviktet e Shkollave te Mesme”** me fond limit/ vlere te pritshme te kontrates **2.523.897** (dymilion e pesëqind e njëzet e tremijë e tetëqind e nëntëdhjetë e shtatë) **lekë pa tvsh.**

Burimi i financimit:Buxheti i Shtetit dhe buxheti i Bashkisë Tiranë.

Publikime të mëparshme : Buletini i Njoftimeve Publike Nr.47, date 25.11.2019

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë me vlerat përkatëse të ofruara:

1- Operatori ekonomik **“Dajti Park 2007” shpk** NUIS
K11507003S

Vlera e ofertës = **2.212.000** (dymilion e dyqind e dymbëdhjetëmijë) **lekë pa TVSH.**

2- Operatori ekonomik **“ Dogel ” sh.p.k** NUIS
K59418208E

Vlera e ofertës = **1.624.000** (njëmilion e gjashtëqind e njëzet e katërmijë) **lekë pa TVSH.**

3- Operatori ekonomik **“ 4 S ” sh.p.k** NUIS **L64425401K**

Vlera e ofertës = **2,520,000** (dy milionë e pesëqind e njëzetmijë) **lekë pa TVSH**

4- Operatori ekonomik **“Nelsa” shpk** NUIS
J71601012S

Vlera e ofertës = **1.736.000** (njëmilion e shtatëqind e tridhjetë e gjashtëmijë) **lekë pa TVSH.**

5- Operatori ekonomik **“Kadra ” sh.p.k** NUIS
K31321008J

Vlera e ofertës = **1.610.000** (njëmilion e gjashtëqind e dhjetëmijë) **lekë pa TVSH.**

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. Operatori ekonomik	“Dogel” shpk	NUIS	K59418208E
2. Operatori ekonomik	“Nelsa” shpk	NUIS	J71601012S
3. Operatori ekonomik	“Dajti Park 2007” shpk	NUIS	K11507003S
4. Operatori ekonomik	“Kadra ” sh.p.k	NUIS	K31321008J

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1. Operatori ekonomik **“Dogel” shpk** NUIS **K59418208E**

1.1 Në dokumentat e tenderit, kriteret e vecanta për kualifikim, **pika 1.3.2** e kapaciteti teknik kërkohet specifikisht sa më poshtë:

Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se disponon Furrë buke, linjë e prodhimit të bukës, të pajisur Licencën e Nënkategorisë: II.1.A.1.Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz lëshuar nga (QKB), me leje higjeno sanitare, leje mjedisore e tipit C me kodin III.1.A, certifikatën e dezinfektimit 3D si dhe raport analizën mbi përmbajtjen mikrobiologjike të ujit të përdorur në furrë të vlefshme në momentin e hapjes së ofertave. Furra e bukës, linjë e prodhimit të bukës duhet të jetë në pronësi ose me qera ose me marrëveshje bashkëpunimi.

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik "Dogel" shpk konstatohet se në përmbushje të kesaj pike operatori ekonomik "Dogel" shpk nuk ka paraqitur dokumentacion që vërteton se disponon furrë buke në pronësi apo me qera dhe për rrjedhojë nuk ka paraqitur dhe dokumentacion shoqërues si Licencën e Nënkategorisë: II.1.A.1.Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz lëshuar nga (QKB), leje higjeno sanitare, leje mjedisore e tipit C me kodin III.1.A, certifikatën e dezinfektimit 3D si dhe raport analizën mbi përmbajtjen mikrobiologjike të ujit të përdorur në furrë të vlefshme në momentin e hapjes së ofertave duke mos plotësuar pikën 1.3.2 të kriterëve të vecanta për kualifikim, kapaciteti teknik.

1.2 Në dokumentat e tenderit, kriteret e veçanta për kualifikim, **pika 1.3.3** e kapacitetit teknik kërkohet specifikisht sa më poshtë:

"Operatori ekonomik të paraqesë licencën Licencë lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) me kategoritë e mëposhtëme:

Kategoria: II.1 Prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve.

Nënkategoria: II.1.A.1. Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz.

Licenca duhet të jetë në emër të operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurë pasi duhet ti përkasë operatorit të interesuar të ofertojë për procedurën e prokurimit të shpallur nga Autoriteti Kontraktor."

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik "Dogel" shpk konstatohet se në përmbushje të këtij kriteri operatori ekonomik "Dogel" shpk nuk ka paraqitur licencën e kategorisë II.1, Nënkategoria II.1.A.1 duke mos plotësuar pikën 1.3.3 të kriterëve të veçanta për kualifikim, kapaciteti teknik

1.3 Në dokumentat e tenderit, kriteret e vecanta për kualifikim, **pika 1.3.4** e kapaciteti teknik kërkohet specifikisht sa më poshtë:

"Operatori ekonomik të paraqesë raportin e analizës së kryer për artikullin bukë në emër të prodhuesit e cila të përmbajë të gjithë treguesit e nevojshem fiziko-kimikë të lëshuar nga laboratorë të licensuar nga organet kompetente të lëshuar jo më parë se 30 (tridhjetë) ditë nga hapja e ofertave për artikullin bukë (1kg)."

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik "Dogel" shpk konstatohet se në përmbushje të këtij kriteri operatori ekonomik "Dogel" shpk nuk ka paraqitur raportin e analizës për artikullin buke (1kg) duke mosplotësuar pikën 1.3.4 të kriterëve të veçanta për kualifikim, kapaciteti teknik.

1.4 Në dokumentat e tenderit, kriteret e vecanta për kualifikim, **pika 1.3.5** e kapacitetit

teknik kërkohet specifikisht sa më poshtë:

"Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të disponojë Çertifikatë ISO 9001-2015, ISO 22000:2018 dhe H.A.C.C.P ose ekuivalente me to, të vlefshme.

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, ëdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë Certifikatat ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes)."

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik "Dogel" shpk konstatohet se në përmbushje të këtij kriteri operatori ekonomik "Dogel" shpk nuk ka paraqitur çertifikatat ISO 9001-2015, ISO 22000:2018 dhe H.A.C.C.P duke mosplotësuar pikën 1.3.5 të kriterëve të veçanta për kualifikim, kapaciteti teknik.

1.5 Në dokumentat e tenderit, kriteret e veçanta për kualifikim, **pika 1.3.6** e kapaciteti teknik kërkohet specifikisht sa më poshtë:

"Operatori ekonomik ofertues në rast se është vetë prodhues i bukës duhet të ketë të punësuar në stafin e tij një teknolog ushqimor, ndërsa në rast se nuk është vetë prodhues i bukës, por ka një marrëveshje bashkëpunimi duhet të vërtetojë se prodhuesi i bukës me të cilin ka marrëveshje bashkëpunimi të ketë të punësuar në stafin e tij një teknolog ushqimor. Për përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik ofertues duhet të kontratë pune, diplomë, librezë shëndetësore dhe të jetë i përfshirë në listpagesat e shoqërisë për vitin 2019. "

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik "Dogel" shpk konstatohet se në përmbushje të këtij kriteri operatori ekonomik "Dogel" shpk nuk ka paraqitur dokumentacion për teknologun ushqimor, kontratë pune, diplomë, librezë shëndetsore etj duke mosplotësuar pikën 1.3.6 të kriterëve të veçanta për kualifikim, kapaciteti teknik.

1.6 Në dokumentat e tenderit, kriteret e veçanta për kualifikim, **pika 1.3.7** e kapacitetit teknik kërkohet specifikisht sa më poshtë:

"Operatori Ekonomik duhet të ketë, 2 (dy) mjete transporti ATP, në pronësi ose në përdorim, sipas kontratës noteriale, të vërtetuar me:

-leje qarkullimi,

-siguracion,

-taksat e mjetit,

-leje e transportit që leshohet nga Bashkia,

-kontroll i mjetit,

-leje higjeno-sanitare,

-Certifikate pronësie.

(dokumentacioni i kerkuar te jete i vlefshëm ne perputhje me dispozitat ligjore në fuqi) "

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik "Dogel" shpk konstatohet se në përmbushje të këtij kriteri operatori ekonomik "Dogel" shpk nuk ka paraqitur dokumentacion për mjetet e transportit duke mosplotësuar pikën 1.3.7 të kriterëve të veçanta për kualifikim, kapaciteti teknik.

Pra sa më sipër Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i ofertës së operatorit ekonomik "Dogel" shpk në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për "Prokurimin publik", i ndryshuar dhe në mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për "Miratimin e rregullave të prokurimit publik", **e shpall të pavlefshme këtë ofertë** pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

2. Operatori ekonomik “Nelsa” shpk

NUIS J71601012S

2.1 Në dokumentat e tenderit, kriteret e veçanta për kualifikim, **pika 1.3.2** e kapacitetit teknik kërkohet specifikisht sa më poshtë:

"Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se disponon Furrë buke, linjë e prodhimit të bukës, të pajisur me Liçencën e Nënkatëorisë: II.1.A.1.Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz lëshuar nga (QKB), me leje higjieno sanitare, leje mjedisore e tipit C me kodin III.1.A, certifikatën e dezinfektimit 3D si dhe raport analizën mbi përmbajtjen mikrobiologjike të ujit të përdorur në furrë të vlefshme në momentin e hapjes së ofertave. Furra e bukës, linjë e prodhimit të bukës duhet të jetë në pronësi ose me qera ose me marrëveshje bashkëpunimi."

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se operatori ekonomik “Nelsa” shpk e ka një marrëveshje bashkëpunimi për furnizimin me bukë me personin fizik Ilir Mustafai por në dokumentacionin e paraqitur për plotësimin e kësaj pike nuk është paraqitur çertifikata e dezinfektimit 3D sikundër kërkohet në kriteret e veçanta për kualifikim, kapaciteti teknik. Gjithashtu në raportin e analizës së ujit nuk është përcaktuar që vendi i marrjes së kampionit është furra e bukës. Pra në plotësim të këtij kriteri operatori ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacion të plotë për furrën e bukës duke mos plotësuar kriteret e veçanta për kualifikim, pika 1.3.2.

2.2 Në dokumentat e tenderit, kriteret e veçanta për kualifikim, **pika 1.3.3** e kapacitetit teknik kërkohet specifikisht sa më poshtë:

"Operatori ekonomik të paraqesë liçencën : Liçencë lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) me kategoritë e mëposhtëme:

Kategoria: II.1 Prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve.

Nënkatëoria: II.1.A.1. Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz.

Licenca duhet të jetë në emër të operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurë pasi duhet ti përkasë operatorit të interesuar të ofertojë për procedurën e prokurimit të shpallur nga Autoriteti Kontraktor."

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “Nelsa” shpk konstatohet se në përmbushje të këtij kriteri operatori ekonomik “Nelsa” shpk nuk ka paraqitur liçencën e kategorisë II.1, Nënkatëoria II.1.A.1 duke mos plotësuar pikën 1.3.3 të kriterëve të veçanta për kualifikim, kapaciteti teknik.

Pra sa më sipër Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i ofertës së operatorit ekonomik “Nelsa” shpk në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

3. Operatori ekonomik “Dajti Park 2007” shpk

NUIS K11507003S

3.1 Ky operatori ekonomik është skualifikuar në zbatim të Vendimit nr. 86/2020 datë

26.02.2020 te Komisionit te Prokurimit Publik ku gjykon:
se operatori ekonomik **“Dajti Park 2007” shpk** nuk ploteson **pikën 1.3.4** të kriterëve të veçanta për kualifikim, lidhur me paraqitjen e raport analizes se produktit "buke" ne perputhje me specifikimet teknike.

4. Operatori ekonomik “Kadra ” sh.p. NUIS K31321008J

4.1 Ky operatori ekonomik eshte skualifikuar ne zbatim te Vendimit nr. 86/2020 datë 26.02.2020 te Komisionit te Prokurimit Publik ku gjykon:
se operatori ekonomik **"Kadra" shpk** nuk ploteson **pikën 1.3.4** të kriterëve të veçanta për kualifikim, lidhur me paraqitjen e raport analizes se produktit "buke" ne perputhje me specifikimet teknike.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se është identifikuar si operator ekonomikë i suksesshëm:

Operatori ekonomik **“ 4S” sh.p.k NUIS L64425401K** me adrese Fier Lushnje Lagjja Xhevdet Nepravishta, Rruga Çajupi, godine nje kateshe, mbrapa shkolles Liri Kazazi nr 199.

Vlera e ofertës = 2,520,000 (dy milionë e pesëqind e njëzet mijë) **lekë pa TVSH**

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë **Autoritetit Kontraktor, Drejtorisë së Konvikteve të Shkollave të Mesme, Tiranë** me adresë Rruga: Jeronim De Rada pranë Shkollës Teknike Ekonomike, tel: 355 42 23 3826 dhe kontakti i personit përgjegjës Alketa Gjyshi, Nr. Tel: 0682093450, e-mail: gjyshialketa@yahoo.com brenda **5 (pese) ditëve** nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **02.03.2020.**

Ankesa:

Lidhur me Njoftimin e Klasifikimit të bërë në datë **17.01.2020 nga KVO**, Gjatë afatit Ligjor për pritjen e ankesave të shoqërive pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Nenit 63 te Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “ Për prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar për Lotin e parë: “Blerje buke për Konviktet e Shkollave te Mesme”, **është paraqitur ankesë nga Operatori ekonomik “4 S” shpk.**

Me date 25.01.2020, pasi është marrë në shqyrtim ankesa e operatorit ekonomik “4 S” shpk dhe pas verifikimit të pretendimeve të operatorit ekonomik referuar dokumentacionit të paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave ka vendosur te mos pranoje

ankesen e paraqitur nga operatori ekonomik "4 S" shpk.

Operatori ekonomik "4 S" shpk ka mare pergjigje per ankesen me ane të shkresës Nr.97, datë 25.01.2020. Pas kthimit të përgjigjes nga Autoriteti Kontraktor operatori ekonomik "4 S" shpk referuar akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi ka ushtruar të drejtën e ankimimit pranë Komisionit të Prokurimit Publik në datë 03.02.2020.

Pas shqyrtimit të ankesës Komisioni i Prokurimit Publik me anë të vendimit nr. 86/2020 datë 26.02.2020, ka vendosur të pranojë ankesën e operatorit ekonomik "4 S" shpk për procedurën e prokurimit me objekt Loti I "Blerje buke për Konviktet e Shkollave të Mesme", anulimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, duke skualifikuar operatorin ekonomik "Kadra" shpk dhe operatorin ekonomik "Dajti Park 2007" shpk.

Në datën 02.03.2020 pas paraqitjes së vendimit nr. 86/2020 datë 26.02.2020, të Komisionit i Prokurimit Publik pranë Autoritetit Kontraktor me protokoll hyrës Nr.221Prot, datë 02.03.2020 u krye rivlerësimi në zbatim të vendimit të KPP-së Pra, Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 02.03.2020.

Pas klasifikimit të kryer gjatë afatit Ligjor për pritjen e ankesave të shoqërive pjesmarrëse në tender në mbështetje të Nenit 63 të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin Publik" (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar për Lotin e parë: "Blerje buke për Konviktet e Shkollave të Mesme", në datën 09.03.2020 me protokoll hyrës Nr.239 Prot është paraqitur ankesë nga Operatori ekonomik "KADRA" shpk

Me date 13.03.2020, pasi është marrë në shqyrtim ankesa e operatorit ekonomik "Kadra" shpk dhe pas verifikimit të pretendimeve të operatorit ekonomik referuar dokumentacionit të paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave ka vendosur të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik "Kadra" shpk.

Operatori ekonomik "Kadra" shpk ka marrë përgjigje për ankesën me anë të shkresës Nr.258, datë 13.03.2020. Pas kthimit të përgjigjes nga Autoriteti Kontraktor operatori ekonomik "KADRA" shpk referuar akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi nuk e ka ushtruar të drejtën e ankimimit pranë Komisionit të Prokurimit Publik duke lene në fuqi klasifikimin e dates 02.03.2020.